



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR  
PËR KRYETAR BASHKIA HAS PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar Bashkia Has për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1 gërma a dhe neni 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**VËREN**

Me vendimin nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ", KQZ ka përcaktuar disa rregulla për mënyrën e regjistrimit të koalicioneve zgjedhore. Në përputhje me vendimin nr.32 të KQZ, partitë politike depozituan respektivisht në KQZ marrëveshjet e tyre dhe KQZ me vendimet përkatëse ka miratuar regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019 dy koalicione zgjedhore, Koalicionin Aleanca për Shqipërinë Europiane



**Nr. 687 i vendimit    Data 28.05.2019 e vendimit    Ora 12.00 e Vendimit**

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Has, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

(ASE) dhe Koalicionin Shpresa për Ndryshim (SHN). Brenda afatit të përcaktuar në nenin 67, pika 1 dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor, Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) depozitoi kërkesën për regjistrimin e z. Liman Alush Morina si kandidat për kryetar bashkie Has.

KZAZ nr.10 me vendim nr.09, datë 21.05.2019 vendosi të regjistrojë z. Liman Alush Morina si kandidat për kryetar bashkie Has propozuar nga koalicioni ASE.

ASE është subjekti i vetëm që ka depozituar kërkesën pranë KZAZ për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie.

Duke qënë se për zonën zgjedhore bashkia Has është regjistruar vetëm një kandidat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në këtë rast nuk mund të organizojë shortin për rënditjen e kandidatëve në fletën e votimit sipas nenit 93 pika 3 Kodi Zgjedhor.

Në përfundim të procesit të regjistrimit të kandidatit për Kryetar për zonën zgjedhore Bashkia Has, KQZ në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 23, pika 1 germa a, nenin 98, pika 3, 4 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për Kandidat për Kryetar në zonën zgjedhore Bashkia Has, Qarku Kukës për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 687 i vendimit      Data 28.05.2019 e vendimit      Ora 12.00 e Vendimit**

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Has, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.